

Termet e Referencës

Ekspert/e për hartim të dokumentit

HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuar përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Handikos for Child Rights-H4CR”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmes këtij projekti HANDIKOS synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

II. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS kërkon të angazhojë një ekspert/e për hartimin e një manuali që shpjegon Auditimin Social Miqësor për Fëmijët në një mënyrë të thjeshtë dhe tërheqëse, për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre. Ky manual do të shërbejë si një udhëzues hap pas hapi se si të monitorohen projektet publike duke ofruar shembuj praktikë, si të vlerësohet nëse ato plotësojnë nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe si të sigurohet që institucionet të mbeten përgjegjëse. Ky manual pritet t'u ofrojë fëmijëve dhe familjeve të tyre njohuritë dhe aftësitë për të mbikëqyrur projektet publike që i prekin ata, duke siguruar që ata të mund të avokojnë në mënyrë efektive për të drejtat e tyre dhe të kontribuojnë në një komunitet më gjithëpërfshirës.

Kandidati/ja pritet të:

- Zhvillojë përmbajtjen dhe strukturën e një manuali që përfshin:
 - Një hyrje në auditimin social në gjuhë të thjeshtë duke qartësuar kuptimin dhe rëndësinë e auditimit social si mjet për pjesëmarrje qytetare dhe mbikëqyrje të shërbimeve publike;
 - Ndikimin që ka auditimi social në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës nga institucionet publike;
 - Hapat dhe metodat për kryerjen e auditimeve sociale;
 - Nxitjen e përfshirjes aktive të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre në proceset e vendimmarrjes dhe monitorimit të shërbimeve që i prekin drejtpërdrejtë.

Manuali duhet të jetë:

- I qartë dhe i përshtatshëm për moshat e ndryshme të fëmijëve;
- Një mjet praktik që mund të përdoret nga organizatat dhe komuniteti për ndërgjegjësim dhe veprim konkret në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.

III. KUALIFIKIMI

Kandidati/ja duhet të ketë:

- Ekspertizë në llogaridhënien sociale, angazhimin qytetar ose fusha të lidhura;
- Përvojë në zhvillimin e përmbajtjes miqësore për fëmijët, mundësisht me fokus në përfshirjen e aftësive të kufizuara;
- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe shkrimi profesional;
- Njohuri për kontekstin lokal dhe të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë përbëjnë përparësi.

IV. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Kandidati/ja i/e angazhuar duhet të:

- Hartojë manualin bazuar në kërkesat e HANDIKOS dhe në konsultim me ekipin e projektit;
- Rishikimi i dokumenteve relevante për auditimin social dhe pjesëmarrjen qytetare të fëmijëve dhe prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Hulumtimi i praktikave ekzistuese në nivel lokal dhe ndërkombëtar për auditime sociale miqësore për fëmijët;
- Hartimi i përmbajtjes edukative dhe informuese në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.

V. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS.

Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Maj 2025 në bazë ditore, ku do të përfshihet:

Detyra	Kohëzgjatja
Angazhimi i ekspertit/es për hartimin e manualit	7 ditë

VI. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas ofertës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të lëshohet nga ai/ajo, pas finalizimit të dokumentit/manualit.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

VII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologji e punës për këtë angazhim;
- Curriculum Vitae (CV) (max.3 faqe);
- Propozimi financiar.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org
cc: nora.simitciu@handi-kos.org & antika.maksutaj@handi-kos.org

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për: **Ekspert/e për hartimin e një manuali për auditimin social miqësor ndaj fëmijëve.**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 14/05/2025, ora 17:00.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk është nën hetime;**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kriterëve të tyre.